

GJON BORIÇI

DORËHEQJA E DETYRUAR E ENVER HOXHËS SI KRYEMINISTËR I RPSH-SË DHE KREDIA E PARË KINEZE AKORDUAR SHQIPËRISË, 1954

"Tërmet" në qeverinë komuniste shqiptare

Burimet historike në lidhje me Shqipërinë e periudhës së Luftës së Ftohtë vijojnë gjithnjë të na surprizojnë. Duke qenë se marrëdhëniet me Kinën kanë qenë prej afro një dekade në fokusin e studimeve të mia, përmirësimi i vazhdueshëm i njohurive personale në lidhje me këto marrëdhënie, mbetet gjithnjë pasion. Zbulimi i fakteve të reja lidhur me këtë periudhë më shtyu që të rishikoj disa nga tezat e mia në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-kineze, për të cilat kam shkruar edhe më herët. Në këtë artikull, jam përqendruar në një vit kritik përsa i përket zhvillimeve politike të brendshme dhe ndërkombëtare dhe personalisht Enver Hoxhës dhe fatit të fillimit të afrimit të plotë të Shqipërisë së udhëhequr prej tij me Republikën Popullore të Kinës [më tej: RPK].

Në datën 30 prill 1954, Komiteti Qendror [më tej: KQ] i Partisë së Punës të Shqipërisë [më tej: PPSH], vlerësoi punën e instancave drejtuese të vendit mbi dobësitë ekonomike të paraqitura në letrën që sekretari i parë i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Nikita Hrushov, i dërgoi udhëheqjes komuniste shqiptare më 28 dhjetor 1953.¹ Në vendimin e Plenumit të KQ që u mblodh për këtë qëllim në prill 1954, u vendos t'i paraqiteshin strukturave të partisë punimet e Plenumit me anën e një Rezolucioni me titull "Mbi të metat dhe detyrat në drejtimin e çështjeve ekonomike shtetërore dhe mbi zhvillimin e sektorëve kryesorë të ekonomisë në dy vitet e fundit të planit të parë pesëvjeçar".² Në vendim ishte shprehur qartë se ekonomia shqiptare nuk

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Organet Udhëheqëse (më tej: OU), Viti (më tej: V.) 1954, Dosja (më tej: D.) 1, fl. 152. Raporti i Byrosë Politike mbi të metat dhe detyrat në drejtimin e çështjeve ekonomike shtetërore dhe mbi zhvillimin e sektorëve kryesorë të ekonomisë në vitet e fundit të planit të parë pesëvjeçar.

² Po aty.

ishte ende në gjendje të përballonte shpenzime të tjera që kishin të bënin me mekanizimin e punimeve në bujqësi dhe me përmirësimin e industrisë së naftës. Për këtë u ra dakord unanimitisht në Plenum që t'i kërkohej Bashkimit Sovjetik një kredi e re për bujqësinë prej 30 milion rublash, dhe për industrinë e naftës kredi prej 45 milion rublash vetëm për periudhën 1954-1956.³ Analiza treditore (16, 17, 18 prill 1954)⁴ që po bënte Komiteti Qendror i PPSH-së duhet patjetër të dilte me një vendim të rëndësishëm politik.

Kishin kaluar gati dhjetë vjet që kur kishte mbaruar lufta në Shqipëri. Por, represioni dhe abuzimet me pushtetin padiskutim që do të jepnin efektet e tyre shumë negative në ekonomi. Ekzekutimi, internimi, burgosjet e shumë specialistëve dhe ekspertëve shqiptarë në çdo fushë të jetës, do t'i sillnin një dëm ekonomik dhe shoqëror të madh vendit. Forcimi i ekonomisë së vendit nuk do të vinte nga propaganda e Plenumit të KQ, por duke vlerësuar dhe investuar me kujdes në sferat ekonomike të jetës. Si çdo herë, Plenumi mori zotim dhe i premtonte jo popullit shqiptar, por Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik se do të angazhohej me të gjitha forcat dhe energjitë për të përmirësuar gjendjen ekonomike të Shqipërisë.⁵ Raporti vlerëson se KQ nuk ishte marrë mjaftueshëm dhe seriozisht me çështjet ekonomike të vendit dhe për këtë arsye ecja ekonomike e Shqipërisë ishte spontane.⁶

Pjesa ku qeveria shqiptare ngarkohet me përgjegjësi në këtë Plenum,⁷ është edhe elementi më i rëndësishëm i këtij dokumenti për të na dhënë një indicie të qartë se ishin të pritshme ndryshimet në qeveri. Në rezolucion merrej zotimi se tani e tutje bujqësia do të merrte zhvillimin më të madh për ta nxjerrë nga prapambetja dhe për të bërë të mundur

³ *Po aty*, fl. 155.

⁴ *Po aty*, fl. 154.

⁵ *Po aty*, fl. 157.

⁶ *Po aty*.

⁷ *Po aty*, fl. 157-158. Pjesë nga rezolucioni i KQ të PPSH-së: "Këshilli i Ministrave nuk ka siguruar si duhet udhëheqjen e pa ndërprerë të aktivitetit ekonomik e shtetëror të vendit, nuk ka siguruar kurdoherë zbatimin e plotë të vendimeve të veta dhe të partisë nga ana e organeve dhe institucioneve shtetërore vartëse. Këshilli i Ministrave nuk është marrë seriozisht me studimin e çështjeve kryesore të ekonomisë dhe të shtetit, i ka studiuar dhe është përpjekur që t'i zgjidhë këto çështje, të shumtën e herëve, të shkëputura nga njëra tjetra, nuk ka marrë masat e nevojshme për të forcuar disiplinën shtetërore dhe për të luftuar burokracinë e formalizmin në drejtimin e çështjeve ekonomike e shtetërore nga organet dhe institucionet vartëse".

likuidimin e disproporcionit që ekzistonte mes saj dhe industrisë.⁸ Rezolucioni i KQ të PPSH-së i datës 26 prill 1954, nuk iu bë asnjëherë i ditur popullit shqiptar.⁹

Më 26 prill, Enver Hoxha në cilësinë e kryeministrit dhe sekretarit të Përgjithshëm të KQ të PPSH-së, mbledh Byronë Politike për t'u konsultuar mbi përmbajtjen që duhet të kishte letra që do t'i dërgohej Bashkimit Sovjetik lidhur me plotësimin e mangësive nga ana e qeverisë shqiptare.¹⁰ Enver Hoxha e kishte thirrur sa për sy e faqe këtë mbledhje të Byrosë Politike, pasi siç e pohon edhe vetë, letrën e kishte shkruar siç dëshironte dhe madje e kishte konsultuar edhe me ambasadorin sovjetik në Tiranë, Leviçkin.¹¹ Këtë mbledhje, ai e kishte thirrur pas vërejtjeve dhe sugjerimeve të ambasadorit sovjetik.¹² Në fakt, i gjithë problemi i letrës së Komitetit Qendror të PPSH-së ishte sesi duhej të justifikonin shifrat. Këtë fakt e pranon vetë Enver Hoxha kur në fund të mbledhjes së Byrosë Politike si fjalë të fundit, thotë:

"...kemi për të shtruar edhe disa çështje në lidhje me forcat e armatosura, në lidhje me furnizimin dhe disa probleme të tjera organizative, por pa thënë shifra".¹³

Letra që iu dërgua Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik është e mbushur plot e përplot me justifikime të panevojshme ku, ajo që binte në sy, ishin rezultatet e dobëta në bujqësi dhe megjithatë Hoxha premtojte se brenda tre viteve do të zgjidhej problemi i bukës në vend.¹⁴ Në fund të saj, Enver Hoxha në emër të KQ të PPSH-së i lutet Nikita Hrushovit që të shqyrtohej edhe një herë mundësia e shtyrjes së afateve të shlyerjes së kredive për një periudhë më të gjatë, të paktën edhe për pesë vjet.¹⁵ Qeveria shqiptare ndodhej përpara

⁸ *Po aty*.

⁹ *Po aty*, fl. 159. Nga shënimi në fund të dokumentit: "Ky rezolucion është dokument sekret dhe të mbetet në arkivat e Komitetit Qendror të Partisë".

¹⁰ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1954, D. 14, fl. 13. Proces-verbal i mbledhjes së Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH-së për aprovimin e letrës që do t'i drejtohet K.Q. të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, datë 26 prill 1954.

¹¹ *Po aty*, fl. 13.

¹² *Po aty*.

¹³ *Po aty*, fl. 17.

¹⁴ *Po aty*, fl. 4.

¹⁵ *Po aty*, fl. 10.

një krize të vërtetë besimi në marrëdhëniet e saj me Partinë Komuniste dhe qeverinë e Bashkimit Sovjetik.

Siç ndodhte rëndom, sa herë që kishte ndonjë krizë, problemet e mprehta që u vunë në dukje gjatë mbledhjes së Komitetit Qendror, do t'i hapnin udhë letrave që do t'i dërgoheshin kryeministrit Hoxha për të filluar goditjet. Një nga letrat më të bujshme është ajo që Rrapo Dervishi i dërgon "shokut Komandant" për punën e dobët të ministrit të Bujqësisë, Hysni Kapos për mosplotësim të detyrave sidomos për qarkun e Gjirokastrës.¹⁶ Gjithashtu në letër, Rrapo Dervishi përpiket të mbrojë veten nga kritika që i ishte bërë nga Rita Marko për disa lëvizje të pamatura që kishte bërë në disa sektorë në Delvinë.¹⁷

Enver Hoxhës nuk i interesonte në këto momente të godiste shokë partie kur vetë kishte ngrënë një "dackë" të mirë nga Hrushovi për keqmenaxhimin e ekonomisë së vendit si kryeministër. Përgjegjësia për performancën e dobët të qeverisë shqiptare ishte e tij. Urdhrrat për drejtimin ekonomik të vendit vinin vetëm nga ai dhe nga askush tjetër. Duhet bërë një lëvizje që t'i lihej të kuptonte udhëheqjes së Bashkimit Sovjetik se qeveria shqiptare do t'i realizonte detyrat e marra përsipër. Në fund të qershorit një delegacion i lartë i udhëheqjes shqiptare i kryesuar nga Enver Hoxha shkoi për bisedime në Bashkimin Sovjetik. Pas kthimit në atdhe, më datë 12 korrik 1954, kryeministri shqiptar raporton në Plenumin XI të KQ të PPSH-së lidhur me vizitën e tij në Moskë dhe për disa ndryshime të rëndësishme.¹⁸ Në këtë dokument, data e vizitës në Moskë nuk jepet. Delegacioni shqiptar në Moskë i kryesuar nga vetë Enver Hoxha, kishte kërkuar një kredi të re deri në 45 milion rubla duke filluar nga viti 1954.¹⁹ Gjithashtu, delegacioni shqiptar kishte kërkuar të shtyheshin pagesat e ratave deri në vitin 1972, dhe t'i ulej Shqipërisë kamata e kredive të akorduara nga 2% në 1% si dhe t'i akordohej vendit një tjetër kredi prej 20 milion rublash për të mbuluar shpenzimet e tejkalimeve industriale të objekteve të këtij lloji të ndërtuara deri në atë

¹⁶ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1954, D. 1, fl. 232. Dokumenti nuk ka datë dhe është i shkruar me shkrim dore.

¹⁷ *Po aty*, fl. 235.

¹⁸ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1954, D. 2, fl. 1. Mbi punën e delegacionit të partisë dhe të qeverisë shqiptare në Moskë, si dhe mbi disa masa të rëndësishme organizative për forcimin e mëtejshëm të partisë dhe të shtetit.

¹⁹ *Po aty*, fl. 2.

kohë në vend.²⁰ Sipas përlllogaritjeve që kishte bërë Gogo Nushi, tejkalimi ishte vetëm 5 milion rubla ndërsa 15 milionët e tjerë përfaqësonin vlerën e mallrave të konsumit që i ishin dhënë Shqipërisë me klering për vitin 1954.²¹ Po ashtu, delegacioni i lartë shqiptar i kryesuar nga kryeministri Hoxha kishte kërkuar edhe një kredi tjetër prej 6 milion rublash për ngritjen e reparteve të reja në Kombinatin e Tekstileve “Stalin” si dhe për forcimin e mëtejshëm të ushtrisë.²²

Gjatë vizitës në Moskë, delegacionin shqiptar e kishin pritur personalitetet më të larta të Bashkimit Sovjetik. Këshilla që i ishte dhënë delegacionit shqiptar sipas Enver Hoxhës, ishte që punët shtetërore të edukoheshin dhe të kontrolloheshin nga partia, Komiteti Qendror i saj dhe Byroja Politike.²³ Sipas Hoxhës, duhej të ndjehej kudo në vend autoriteti i partisë nga mësimet e nxjerra nga rezolucioni i vitit 1953 i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik mbi tradhtinë e Berias.²⁴ Me gjithë këto fjalë të forta, Enver Hoxha e kishte të pamundur të mos fliste për mesazhin e drejtpërdrejtë që kishte marrë nga Bashkimi Sovjetik. “Këshilla” sipas tij ishte që në krye të partisë duhet të qëndronte një shok me autoritet dhe të mos merrej me asnjë punë tjetër përveçse punëve të partisë, në mënyrë që të forcohej autoriteti i saj, i Komitetit Qendror dhe i Byrosë Politike.²⁵ Nëse sekretari i Parë i Komitetit Qendror do të ishte edhe kryeministër, rrezikohej sipas Hoxhës nga “këshilla” që kishte marrë në Moskë të dobësohej drejtimi dhe kontrolli i partisë mbi Këshillin e Ministrave dhe organet e pushtetit, partia të kthehej në një ndihmëse të qeverisë, të kalonte në radhë të dytë.²⁶ Roli i partisë ishte të drejtonte dhe të kontrollonte çdo gjë, që nga qeveria e deri tek shkallët më të ulëta të pushtetit.²⁷

Për çështjet ekonomike, në Moskë i kishin thënë delegacionit shqiptar që çdo gjë ta bënin me laps në dorë.²⁸ Investimet që dëshironte të bënte qeveria shqiptare në sektorin e naftës nuk ishin të leverdishme. Për

²⁰ *Po aty.*

²¹ *Po aty.*

²² *Po aty.*

²³ *Po aty.*

²⁴ *Po aty*, fl. 3.

²⁵ *Po aty*, fl. 4.

²⁶ *Po aty.*

²⁷ *Po aty.*

²⁸ *Po aty.*

sovjetikët, nafta shqiptare nuk ishte e një cilësie të mirë dhe nuk preferohej shumë.²⁹ Ishte e rëndësishme sipas Hoxhës, që nafta e nxjerrë në vend të studiohej më mirë për të kuptuar leverdishmërinë dhe nëse ishte pozitive, atëherë Bashkimi Sovjetik do të shtonte kreditë.³⁰ Një tjetër këshillë e sovjetikëve që fatkeqësisht Enver Hoxha nuk e zbatoi deri në fund të jetës, ishte mosinvestimi në industrinë e rëndë dhe as që duhej të bëhej fjalë për ngritjen e metalurgjisë së rëndë apo për përpunimin e metaleve në vend.³¹ Në Shqipëri, sipas sovjetikëve duhej të zhvillohej industria ushqimore dhe e fruta-perimeve. Nëse udhëheqja shqiptare do të investonte në këtë drejtim, atëherë patjetër, kreditë dhe ndihmat sovjetike do të ishin të shumta.³²

Bujqësia do të ishte një tjetër sektor ku sovjetikët kishin këmbëngulur për investime nga qeveria shqiptare.³³ Krahas bujqësisë duhej të zhvillohej edhe blegtoria dhe baza e saj ushqimore. Një tjetër kujdes që duhej të bënte qeveria shqiptare sipas sovjetikëve ishte të konsolidonte monedhën (lekun), të shkurtonte emisionet, sepse nëse nuk ndodhte kjo do të shkaktohej inflacion dhe nuk do të mund të kontrolloheshin pakësimet e shpenzimeve.³⁴ Përfundimisht, nëse qeveria shqiptare i kthente në realitet këto këshilla, kreditë nuk do të mungonin, madje kredia që kishin kërkuar për vitin 1954 do të akordohej menjëherë.³⁵ U vendos që për të gjitha vendimet që do të merreshin në këtë mbledhje të informohej menjëherë edhe Byroja Politike e Komitetit Qendror të Bashkimit Sovjetik.³⁶ Në letër u vendos që Bashkimit Sovjetik, pasi t'i premtuhej se do t'i zbatonin zotimet e marra në Moskë, t'i kërkohej edhe një kredi e re prej 75 milion rublash për vitet 1954-1956 e ndarë, 45 milion rubla për naftën dhe 30 milion për bujqësinë.³⁷ Përsëri Enver Hoxha po e drejtonte keq vendin duke vijuar t'i jepte prioritet industrisë së rëndë. Nafta nuk ishte dobidhëse për ekonominë shqiptare

²⁹ *Po aty.*

³⁰ *Po aty.*

³¹ *Po aty*, fl. 5.

³² *Po aty.*

³³ *Po aty.*

³⁴ *Po aty*, fl. 6.

³⁵ *Po aty.*

³⁶ *AQSH*, F. 14/OU, V. 1954, D. 14, fl. 12. Letra që iu dërgua Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të BS nuk ka datë. Mbledhja e Byrosë Politike mbi përmbajtjen e letrës u bë më 26 prill 1954.

³⁷ *Po aty*, fl. 11.

dhe këtë ia kishin thënë hapur sovjetikët, por përsëri ai nuk hiqte dorë nga e vetja. Bujqësia siç shikohet do të kishte një rritje, por krahasuar me industrinë e rëndë, përsëri investimet në këtë sektor do të mbeteshin deri në fund të pushtetit të tij, modeste. Megjithatë, Byroja Politika në mënyrë unanime vendosi që të ndiqej rruga e parashtruar nga Enver Hoxha. Raporti i mbajtur prej tij u kthye në direktivë për partinë³⁸ dhe rrjedhimisht edhe për popullin shqiptar.

Udhëheqësi komunist i Shqipërisë, nuk kishte ndërmend të hiqte dorë nga pushteti i tij absolut. Megjithatë, për t'u dukur në sytë e sovjetikëve se po i reflektonte "këshillat" e tyre, politikisht vendosi të bënte një ndryshim jo të vogël. Vendimi më i rëndësishëm që u mor në Plenumin XI të korrikut 1954, ishte pranimi nga ana e Komitetit Qendror dhe Byrosë Politike të dorëheqjes së Enver Hoxhës nga posti i kryeministrit.³⁹ Mbajtjen e shumë posteve qeveritare nga ana e tij, lideri suprem i vendit e justifikoi se në situatat e vështira që po kalonte vendi pas çlirimit, kishin nevojë për forcim dhe për organizim ndaj ky grumbull funksionesh mund të ishte i nevojshëm dhe i drejtë.⁴⁰ Tani që shteti dhe partia ishin forcuar dhe sipas Enver Hoxhës, punët ishin shtuar, grumbullimi i funksioneve në një person të vetëm bëhej një vështirësi dhe pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të punëve.⁴¹

Për këtë 'largpamësi' të liderit suprem të vendit, Plenumi i KQ me vendim të Byrosë Politike, vendosi të suprimonte funksionin e sekretarit të Përgjithshëm të KQ të PPSH-së si i panevojshëm dhe të krijonte në vend të tij postin e sekretarit të Parë të Komitetit Qendror, që do të drejtonte të gjitha punët, të Byrosë Politike dhe të Sekretariatit.⁴² Si sekretar i Parë i KQ u zgjodh njëzëri Enver Hoxha.⁴³ Sekretarë të KQ të PPSH-së u emëruan Gogo Nushi dhe Liri Belishova.⁴⁴ Plenumi vendosi edhe suprimimin e funksionit të Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë

³⁸ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1954, D. 2, fl. 25/1. Vendim i KQ të Byrosë Politike: "Të konsiderojë direktivë për të gjithë partinë raportin e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror".

³⁹ *Po aty*, fl. 16. Pjesë nga raporti i Enver Hoxhës në Plenum: "Të pranohet propozimi i shokut Enver Hoxha që të shkarkohet nga funksionet shtetërore si kryetar i Këshillit të Ministrave".

⁴⁰ *Po aty*, fl. 16-17.

⁴¹ *Po aty*, fl. 17.

⁴² *Po aty*.

⁴³ *Po aty*.

⁴⁴ *Po aty*.

Popullore si të panevojshëm në këto momente.⁴⁵ Kur ta lypte nevoja, ky funksion mund të krijohej përsëri me të njëjtat attribute si në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare.⁴⁶ Enver Hoxha, edhe pse hoqi dorë nga të gjitha funksionet qeveritare, donte të tregonte se e kishte të gjithë situatën në dorë dhe çdo emërim në qeveri apo në Byronë Politike nuk mund të merrej pa dhënë pëlqimin ai, duke treguar një mesazh të qartë se ishte ende i vetmi që drejtonte të gjitha punët në parti dhe në shtet.⁴⁷ Pas dorëheqjes së tij, më 12 korrik 1954, Plenumi XI me vendim të Byrosë Politike emëroi në postin e kryeministrit, Mehmet Shehun.⁴⁸

Me këto ndryshime të rëndësishme, Enver Hoxha e kishte shumë të qartë se pas vdekjes së Stalinit, Bashkimit Sovjetik ishte bërë i pabesueshëm për pushtetin e tij. Duhej gjetur patjetër një aleat i ri i

⁴⁵ *Po aty*.

⁴⁶ *Po aty*.

⁴⁷ *Po aty*, fl. 18. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës pas dorëheqjes: "Komiteti Qendror i partisë sonë është i bashkuar si një trup i vetëm prej graniti dhe e udhëheq partinë me urtësi dhe me guxim në rrugën e lavdishme të socializmit dhe të komunizmit. Uniteti i partisë sonë është si një bllok çeliku që s'do të ketë forcë armike, qoftë e brendshme, qoftë e jashtme ta dëmtojë. Mendje të sëmura dhe armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të partisë, kur t'i marrin vesh këto masa organizative të drejta dhe të domosdoshme që po merr Komiteti Qendror i partisë për forcimin e partisë dhe të zhvillimit të fitoreve të popullit, do të përpiqen t'i shfrytëzojnë në dëm të shoqërisë sonë socialiste, në dëm të interesave të popullit. Këto mendje të sëmura dhe këta armiq do të përpiqen të shpifin, të trillojnë gjëra të paqena, do të lehin si qenër për një kohë por shpejt do të ngjiren dhe do t'u zihen fyti. Partia, si kurdoherë, të shtojë vigjilencën kundra armiqve të brendshëm dhe të jashtëm të partisë dhe të popullit dhe t'i godasë këta armiq pa pikë mëshire. Partia të bëjë të gjitha përpjekjet që mendjet e sëmura që mund të shërohen t'i shërojë. Çdo gjë bëhet për të mirën e partisë dhe të popullit, prandaj partia përpara, si kurdoherë përpara për fitore të reja".

⁴⁸ *Po aty*, fl. 20, 54. Përbërja e qeverisë së re e Republikës Popullore të Shqipërisë ishte: "Mehmet Shehu, Kryeministër; Hysni Kapo, nënkryetar i parë i Këshillit të Ministrave dhe ministër i Bujqësisë; gjeneral lejtant Beqir Balluku, nënkryetar i parë i Këshillit të Ministrave dhe ministër i Mbrojtjes; Manush Myftiu, nënkryetar i Këshillit të Ministrave; Tuk Jakova, nënkryetar i Këshillit të Ministrave; Spiro Koleka, Kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit; Kadri Hazbiu, ministër i Punëve të Brendshme; Behar Shtylla, ministër i Punëve të Jashtme; Koço Theodhosi, ministër i Industrisë dhe i Minierave; Josif Pashko, ministër i Ndërtimeve dhe Komunikacioneve; Kiço Ngjela, ministër i Tregtisë së Brendshme dhe të Jashtme; Abdyl Këllezi, ministër i Financave; Bilbil Klosi, ministër i Drejtësisë; Bedri Spahiu, ministër i Arsimit dhe i Kulturës; Medar Shtylla, ministër i Shëndetësisë; Shefqet Peçi, Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Shteti".

fuqishëm me staturën e Bashkimit Sovjetik. Pushteti i tij në aleancë me sovjetikët do të ishte gjithnjë i rrezikuar.

Marrëveshjet e para kulturore dhe tekniko-shkencore RPSH – RPK në vitin 1954

Duke qenë dukshëm e rreshtuar në kampin socialist në epokën e Luftës së Ftohtë, Shqipëria nën udhëheqjen staliniste të Enver Hoxhës kishte lidhje diplomatike me çdo vend të këtij kampi. Përjashtim përbënin marrëdhëniet me Jugosllavinë të cilat pas vitit 1948 ishin ndërprerë dhe, megjithëse ishin vendosur pas vdekjes së Stalinit, vijonin të ishin jo miqësore.

Vendimi më i rëndësishëm për këtë periudhë të vitit 1954 ishte ai i Këshillit të Ministrave i 16 marsit 1954 i drejtuar nga vetë kryeministri Enver Hoxha, aprovimi i propozimit për të hapur ambasadën e Republikës Popullore të Shqipërisë në Republikën Popullore të Kinës.⁴⁹ Hapja e ambasadës së RPSH-së në Pekin, ishte një ngjarje me rëndësi për politikën dhe diplomacinë shqiptare. Shqipëria komuniste po hynte në marrëdhënie të drejtpërdrejta me një vend gjigant në Azi i cili në vitet '60 të shek. XX do të ishte varka e shpëtimit të pushtetit të Enver Hoxhës pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Deri në këtë vit, nuk kemi gjetur ndonjë dokument që të na vërtetojë faktin se ishte në strategjinë afatshkurtër të Enver Hoxhës dhe të enturazhit të tij politik, afrimi me Kinën. Kur kishte një vit nga vdekja e Stalinit, RPSH ishte ende e lidhur dhe e varur totalisht nga ndihmat dhe kreditë sovjetike. Deri në këtë vit që kemi marrë në shqyrtim, vetë RPK nën udhëheqjen e kryetarit Mao Ce Dun, ishte shumë e varur nga ndihmat dhe kreditë sovjetike. Sipas arkivave sovjetike të botuara, Bashkimi Sovjetik kishte akorduar për Kinën kredi 9.4 miliard rubla, e ndarë, për pajisje 8.4 miliard rubla dhe për asistencë teknike 1 miliard rubla.⁵⁰ Ndërtimi i veprave në Kinë me ndihmën e Bashkimit Sovjetik i kushtoi buxhetit sovjetik 7% të GDP-së.⁵¹ Gjithashtu, në çdo ministri në RPK ishin vendosur dhjetëra këshilltarë sovjetikë.⁵²

⁴⁹ *Po aty*, fl. 2. Proces-verbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave mbajtur më 16 mars 1954 mbi propozimin dhe krijimin e ambasadës në Republikën Popullore të Kinës.

⁵⁰ Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978*, Tiranë: MIRGEERALB, 2016, f. 107.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² *Po aty*, f. 108.

Marrëdhëniet ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës, që në fillimet e tyre, përveç afrimitetit ideologjik do të kishin si me të gjitha vendet e tjera të kampit socialist specifika përkatëse financiare. Më 30 korrik 1954, Banka e Shtetit Shqiptar sipas studimit që kishte kryer, i kërkonte qeverisë shqiptare që përta i përkiste çështjes së dërgimit të fondeve në Kinë dhe Kore [të Veriut-Gj.B.] dhe në lidhje me plotësimin e nevojave të ambasadës shqiptare në Pekin, të çelej një llogari e Shqipërisë në rubla në Bankën Popullore të Kinës dhe të Koresë.⁵³ Qeveria shqiptare duhet ta ketë pranuar këtë propozim të Bankës së Shtetit Shqiptar*, sepse më datë 4 shtator 1954 nga Banka Popullore e Kinës në Pekin, erdhi aprovimi i kërkesës së Bankës së Shtetit Shqiptar për çeljen e llogarive në vendet respektive.⁵⁴

Pas ndryshimeve në qeveri dhe pas hapjes së ambasadave respektive në Tiranë dhe Pekin, më datë 31 gusht 1954, kryetari i ri i Këshillit të Ministrave të RPSH-së, Mehmet Shehu, mori një telegram nga i ngarkuari me punë i RPK-së në Shqipëri Van Dun (i cili e kishte dërguar me 30 gusht), në të cilin ishte bashkangjitur letra e kryeministrit të Kinës, Çu En Lai**, i cili ftonë në Pekin një delegacion të RPSH-së për nder të përvjetorit të pestë të festës kombëtare të Kinës.⁵⁵ Në letër, Çu En Lai shprehte entuziazmin për të pritur një delegacion të lartë qeveritar nga Republika Popullore e Shqipërisë dhe se populli kinez mezi e priste ardhjen e delegacionit shqiptar i mbërthyer në vazhden e punës për

⁵³ *AQSH*, F. 506/Banka e Shtetit Shqiptar (më tej: BSHSH), V. 1954, D. 38, fl. 1. Pjesë nga studimi i Bankës së Shtetit Shqiptar mbi çeljen e llogarive në rubla në RPK: "Bankat e vendeve respektive do t'i paguajnë ambasadës tonë shumën e rublave të transmetuara nga neve në monedhën e vendit duke e llogaritur në bazë të kursit ekzistues në ditën e pagimit. Kështu, për shembull, kur neve do t'i japim urdhër Bankës së Kinës ose asaj të Koresë që t'i paguajë ambasadës tonë 1000 rubla, Banka përkatëse e Kinës ose e Koresë mbasi do t'i llogaritë rublat me kursin zyrtar në momentin e pagimit, do t'i paguajë ambasadës tonë kundërvleftën në monedhën e vendit dhe do të na debitojë neve në llogarinë tonë në rubla pranë saj. Po kështu do të veprimë edhe neve për urdhërat që do të na japin Bankat e Kinës ose të Koresë".

* Nuk kemi ndonjë konfirmim nga dokumentet që kemi hulumtuar për këtë veprim.

⁵⁴ *Po aty*, fl. 3.

** *Çu En Lai* (Zhou Enlai), 05.03.1898-08.01.1976. Kryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme i Republikës Popullore të Kinës. Në detyrë, 01.10.1949-08.01.1976.

⁵⁵ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1954, D. 696, fl. 1. Ftesë e Qeverisë së R.P. të Shqipërisë, mbi dërgimin e një delegacioni për të marrë pjesë në kremtimin e 5-vjetorit të shpalljes së R.P. të Kinës.

ndërtimin e socializmit dhe zhvillimin e miqësisë së madhe ndërmjet Kinës dhe Shqipërisë.⁵⁶

Padyshim që Mehmet Shehu shprehu dakordësinë e tij që një delegacion i lartë shqiptar të shkonte në Kinë. Madje, aty për aty, me shkrim dore tek letra në variantin shqip të Çu En Lait, me shënimin që t'i dërgohej sekretares së Komitetit Qendror të PPSH, Liri Belishovës, ai propozoi se kush duhej të shkonte në Kinë.⁵⁷

Pas njohjeve të para, me Kinën e Mao Ce Dunit, në një mbledhje me mbishkrimin "Tepër Sekret" të Këshillit të Ministrave të datës 5 nëntor 1954, u morën në shqyrtim draft projektet e marrëveshjeve kulturore dhe tekniko-shkencore ndërmjet RPSH-së dhe RPK-së.⁵⁸ Për faktin se kjo mbledhje dhe materiali i saj ishin "Tepër Sekret", na bën të mendojmë se Enver Hoxha dhe lidhshipi komunist shqiptar pas vdekjes së Stalinit, ishin në kërkim të një "stalinisti" të ri në marrëdhëniet me Shqipërinë. Mao Ce Duni duket se e përmbushte këtë kriter.⁵⁹ Për më tepër, Bashkimi Sovjetik nën udhëheqjen e Stalinit kishte qenë vendi i parë në botë që kishte njohur zyrtarisht Republikën Popullore të Kinës.⁶⁰ Në fakt, kishte një arsye madhore se përse Mao adhuronte Stalinin. Që nga fillimi, Partia Komuniste e Kinës ishte e varur totalisht nga ndihma financiare dhe

⁵⁶ *Po aty*, fl. 2. Pjesë nga letra e Çu En Lait: "Ardhja e delegacionit të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë do të ngjalli një entuziazëm shumë të madh midis popullit kinez, i cili tani është i përveshur punës së ndërtimit socialist dhe transformimit socialist, dhe ka rëndësi të madhe në forcimin dhe zhvillimin e miqësisë së madhe midis Kinës dhe Shqipërisë".

⁵⁷ *Po aty*. Mehmet Shehu me shkrim dore: "Shoqes Liri Belishova, sek. K.Q.P.P.SH. 1) Jam dakord të shkojë delegacioni qeveritar. 2) Propozoj këtë përbërje të delegacionit: a) Behar Shtylla – kryetar; b) Arif Hasko (gjeneral) – anëtar; c) Nesti Nase – anëtar. 3) Do ish mirë të vendoste sekretariati në mbledhjen e parë 1954". Firma e Mehmet Shehut.

⁵⁸ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1954, D. 284, fl. pa numër. Proces verbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, datë 5.11.1954, me dekretin dhe materialin përkatës, mbi shqyrtimin e marrëveshjes kulturele dhe të marrëveshjes tekniko-shkencore midis R.P. të Shqipërisë dhe R.P. të Kinës.

⁵⁹ Kevin Peraino, *A force so swift; Mao, Truman and birth of modern China, 1949*, New York: Crown, 2017, f. 246. Pjesë nga fjala e Mao Ce Dunit me rastin e ditëlindjes së Stalinit, më 21 dhjetor 1949: "Shoku Stalin është një mësues dhe një mik i popujve të botës, ai gjithashtu është një mik i popullit kinez"; shih edhe: Frank Dikötter, *The tragedy of liberation; a history of the Chinese revolution 1945-1957*, New York: Bloomsbury Press, 2013, f. 207.

⁶⁰ K. Peraino, *A force so swift ...*, f. 220. Mao në fjalimin e tij ngriti në qiell sovjetikët pasi kishin qenë kombi i parë në botë që njohën Republikën e re Popullore.

ideologjike e Bashkimit Sovjetik. Stalini kishte ndihmuar personalisht në marrjen e pushtetit nga ana e Maos në Kinë.⁶¹ Sapo flamuri i kuq u ngrit në Pekin më 1 tetor 1949, Mao nuk humbi asnjë sekondë për t'i imponuar Kinës të njëjtin model stalinist si në Bashkimin Sovjetik.⁶²

Ardhja në pushtet në Bashkimin Sovjetik të Nikita Hrushovit, nuk i jepte shumë shpresë Hoxhës se do të vijonte rrugën e komunizmit të egër të Stalinit. Një mbledhje e rëndësishme qeverie nën kryesimin e Mehmet Shehut u bë më datë 5 nëntor 1954, në orën 11 paradite.⁶³ Sipas udhëzimeve që kishte marrë qeveria nga Byroja Politike, në bazë të informacioneve që kishte raportuar delegacioni shqiptar që shkoi në Pekin për pesëvjetorin e themelimit të RPK-së, ishte hapur rruga për firmosjen e një marrëveshjeje kulturore dhe tekniko-shkencore ndërmjet dy vendeve.⁶⁴ Informacioni që na vjen nga kjo mbledhje, është se hapin e parë për të lidhur marrëveshjet përkatëse e kishte bërë delegacioni shqiptar.⁶⁵ Me udhëzimet nga Tirana, delegacioni shqiptar në Pekin i kishte nënshkruar të dyja marrëveshjet sipas propozimeve të palës kineze më datë 14 tetor 1954.⁶⁶ Në këtë relacion, ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Behar Shtylla, që ishte edhe kryetari i delegacionit, i kërkonte qeverisë shqiptare që të aprovonte edhe ajo marrëveshjet në mënyrë që t'i ratifikonte në një kohë sa më të shkurtër Kuvendi Popullor dhe të botoheshin më pas menjëherë në shtyp.⁶⁷

Marrëveshja tekniko-shkencore në nenin 1 të saj saktësonte se Shqipëria dhe Kina do ta ndihmonin reciprokisht njëra-tjetrën në lëmin teknik dhe shkencor teknik me qëllim kontributin e zhvillimit të ndërtimit

⁶¹ Frank Dikötter, *The Cultural Revolution; a people's history 1962-1976*, New York: Bloomsbury Press, 2016, f. 4.

⁶² *Po aty*; shih edhe F. Dikötter, *The tragedy of liberation...*, f. 207. Mao për modelin sovjetik, më 30 qershor 1949: "Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik është mësuesja jonë më e mirë dhe ne duhet të mësojmë prej saj".

⁶³ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1954, D. 284, fl. 1.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 2.

⁶⁵ *Po aty*. Pjesë nga relacioni i mbledhjes së qeverisë më 5 nëntor 1954: "Lidhur me këtë delegacioni i paraqiti palës kineze projekt marrëveshjet përkatëse. Qeveria kineze pasi i shqyrtoi këto paraqiti disa propozime dhe projekte të reja për të dy marrëveshjet".

⁶⁶ *Po aty*. Pjesë nga relacioni i mbledhjes: "Të dy marrëveshjet të nesërmen më datë 15 tetor 1954 u aprovuan nga Qeveria e R.P. të Kinës dhe Marrëveshja mbi bashkëpunimin kultural u ratifikua më datë 16 tetor 1954 nga Komiteti i përhershëm kinez i përfaqësuesve të popullit".

⁶⁷ *Po aty*.

të ekonomive socialiste të të dyja vendeve.⁶⁸ Kjo marrëveshje parashikonte edhe ndërtimin e një komisioni me ekspertë të emëruar nga qeveritë përkatëse, tre shqiptarë dhe tre kinezë i cili do të mblidhej jo më rrallë se një herë në vit në mënyrë të alternuar në kryeqytetet përkatëse.⁶⁹ Marrëveshja u bë në dy ekzemplarë, secili në gjuhën shqipe, kineze dhe ruse. Teksti në të tria gjuhët kishte vlerë të barabartë. Nëse do të lindnin kontradikta, apo në rast ndryshimi do të merrej për bazë teksti në gjuhën ruse.⁷⁰

Marrëveshja për bashkëpunimin kulturor u firmos po atë ditë. Në preambulën hyrëse thuhej se kishte si qëllim favorizimin e njohjes reciproke ndërmjet dy vendeve të shtyrë nga dëshira për marrëdhënie të ngushta në fushën e bashkëpunimit kulturor midis dy popujve.⁷¹ Në marrëveshje bie në sy neni 1 dhe 2 ku do të rritej bashkëpunimi dhe favorizimi i institucioneve të ndryshme shkencore, kulturore dhe arsimore ndërmjet dy vendeve.⁷² Gjithashtu, merrej përsipër përkthimi dhe botimi i veprave më të mira politike, shkencore dhe letrare ndërmjet të dy vendeve.⁷³ Shkëmbimi i gazetave dhe organizimi i leksioneve mbi kulturat reciproke ishte një tjetër pikë që përpiquej të bënte të njohura në të dy vendet nivelin kulturor.⁷⁴ Në marrëveshje, përfshihej edhe zhvillimi i leksioneve mbi kulturën dhe shkencën e palëve kontraktuese dhe i bëheshin të njohura publikut shqiptar dhe kinez sukseset politike, ekonomike dhe kulturore të vendeve përkatëse.⁷⁵ Një tjetër pikë e rëndësishme e kësaj marrëveshjeje do të ishte edhe transmetimi radiofonik i programeve kulturore të të dyja vendeve.⁷⁶ Marrëveshja ishte e vlefshme për pesë vjet.⁷⁷

⁶⁸ *Po aty*, fl. 3. Marrëveshje midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës mbi bashkëpunimin teknik dhe shkencor teknik. Pekin, më 14 tetor 1954.

⁶⁹ *Po aty*.

⁷⁰ *Po aty*. Marrëveshja u nënshkrua për palën shqiptare nga ministri i Jashtëm Behar Shtylla, ndërsa për palën kineze Liao Liu Jan, ministër i Bujqësisë.

⁷¹ *Po aty*, fl. 4. Marrëveshje midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës mbi bashkëpunimin kultural, Pekin, më 14 tetor 1954.

⁷² *Po aty*.

⁷³ *Po aty*.

⁷⁴ *Po aty*, fl. 4.

⁷⁵ *Po aty*, fl. 5.

⁷⁶ *Po aty*.

⁷⁷ *Po aty*. Marrëveshja u firmos nga ministri i Jashtëm i RPSH-së Behar Shtylla dhe për palën kineze nga ministri i Kulturës Popullore, Shen Jan Bin.

Pas kthimit në atdhe dhe relacionit informues që mbajti në mbledhjen e saj më 5 nëntor 1954, qeveria shqiptare atë ditë nën kryesinë e zëvendëskryeministrit Hysni Kapo (mungonin në mbledhje kryeministri Mehmet Shehu dhe ministri i Tregtisë, Kiço Ngjela), miratoi marrëveshjet.⁷⁸ Ministri i Jashtëm, Behar Shtylla informoi me anë të një telegrami qeverinë shqiptare, se kinezët do të plotësonin të gjitha kërkesat e qeverisë shqiptare.⁷⁹ Delegacionin shqiptar e kishte pritur personalisht vetë Çu En Lai, ndërsa delegacionet e tjera sipas Shtyllës, jo.⁸⁰ Sipas ministrit shqiptar, miqësia ndërmjet Kinës dhe Bashkimit Sovjetik ishte e dukshme.⁸¹ Kinezët sipas Behar Shtyllës e shikonin gjendjen politike të lidhur me çështjet ekonomike. Këtë ua kishte thënë vetë kryetari Mao Ce Dun në takimin që kishin patur me të.⁸² Për Enver Hoxhën dhe qeverinë shqiptare ishte e rëndësishme që Kina kishte marrëdhënie të mira me Bashkimin Sovjetik. Lidhja edhe me një shtet të madh komunist nuk mund t'i bënte veçse mirë pushtetit komunist në Shqipëri. Ministri Shtylla njoftoi gjithashtu në mbledhjen e 5 nëntorit 1954, se do të vinte në Shqipëri një delegacion i lartë i kryesuar nga Li Hsien Nien, zëvendëskryeministër dhe ministër i Financave i Republikës Popullore të Kinës.⁸³ Për të dyja marrëveshjet të gjithë anëtarët e qeverisë shprehën dakordësinë e plotë.⁸⁴

⁷⁸ *Po aty*, fl. 6. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave mbajtur më 5 nëntor 1954.

⁷⁹ *Po aty*, fl. 7.

⁸⁰ *Po aty*.

⁸¹ *Po aty*, fl. 8. Nga fjala e Behar Shtyllës në mbledhjen e qeverisë: "Një gjë tjetër që na ra në sy, është miqësia e Bashkimit Sovjetik për Kinën dhe e Kinës për Bashkimin Sovjetik. Këtë e kishin të gjithë punëtorët e Kinës dhe këtë e tregonte edhe ajo që në një kombinat të madh të Tjan Shanit, të gjithë specialistët ishin sovjetikë".

⁸² *Po aty*.

⁸³ *Po aty*. Delegacioni i kryesuar nga Li Hsien Nien do të kishte në përbërje 7 vetë. Li Hsien Nien, ministri i Bujqësisë, Lju Xhe Jo, ambasadori i RPK në Tiranë, Siu I Sin, një atashe tregtar, një sekretar delegacioni, një korrespondent dhe një përkthyes.

⁸⁴ *Po aty*, fl. 9. Pjesë nga mbledhja e Këshillit të Ministrave: "Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave dhe Ministri i Bujqësisë, shoku Hysni Kapo tha: Për marrëveshjen, cili është mendimi i Qeverisë? (Mbasi u vu në votë, të gjithë u shfaqën dakord). Përfundimisht, Këshilli i Ministrave vendosi: Aproximin e marrëveshjes mbi bashkëpunimin kultural dhe mbi bashkëpunimin teknik dhe shkencor-teknik midis Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës dhe dërgimin e tyre Presidiumit të Kuvendit Popullor për dekretim konform nenit 58 të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë".

Tek të dyja marrëveshjet ekzistonte e njëjta frymë dhe përmbajtje si me të gjitha marrëveshjet që kishte nënshkruar RPK me vendet e demokracive popullore.⁸⁵ Shqipëria ishte në hapat e parë të lidhjes së gjithanshme me Kinën. Nuk ishte ende vendi më mik i saj. Delegacioni i lartë kinez duhej pritur sa më mirë. Për këtë arsye u akordua një fond prej 60 mijë lekësh nga Ministria e Financave për të rregulluar ambientet e hotel Dajtit.⁸⁶ Por shuma e mësipërme nuk ishte e mjaftueshme për të rregulluar ashtu siç duhet ambientet e tij, kështu që u autorizua një shtesë fondi prej 180 mijë lekësh.⁸⁷

Presidiumi i Kuvendit Popullor nuk vonoi sipas nenit 58 të Kushtetutës së RPSH, të ratifikonte marrëveshjen e bashkëpunimit kulturor me Republikën Popullore të Kinës.⁸⁸ Nga dokumentet që kam hulumtuar, marrëveshja për bashkëpunimin tekniko-shkencor nuk ka ratifikim nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe për këtë fakt nuk sqarohen arsyet. Edhe pse me letërporosi të posaçme, marrëveshja për bashkëpunimin teknik dhe shkencor-teknik ishte dërguar nga ministri Behar Shtylla Presidiumit të Kuvendit Popullor⁸⁹, ajo ishte miratuar vetëm nga qeveria. Ndërsa pala kineze i ka miratuar dhe ratifikuar të dyja marrëveshjet.⁹⁰ Shqipëria konsiderohej shtet socialist në kuptimin e plotë të fjalës dhe si e tillë, sipas ministrit Behar Shtylla do të kishte përkrahjen e Kinës pasi siç i kishte thënë në Pekin vetë Mao Ce Duni “ne [kinezët] ecim ngadalë kurse Shqipëria shkon më shpejt në të gjitha drejtimet. Shqipëria është tigër dhe Kina që të shkojë përpara, ka nevojë për tigra, d.m.th. ka nevojë për Shqipërinë”.⁹¹ Behar Shtylla i kishte lënë të kuptojë

⁸⁵ *Po aty*, fl. 12.

⁸⁶ *Po aty*, fl. 17. Informacion dërguar Tuk Jakovës nga ministri i Tregtisë Kiço Ngjela. Tiranë, më 15 nëntor 1954.

⁸⁷ *Po aty*.

⁸⁸ *Po aty*, fl. 19-21. Dekret për ratifikimin e Marrëveshjes midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës mbi bashkëpunimin kulturor, Tiranë, më 6 nëntor 1954. Nr. i dekretit 1951. Kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Haxhi Lleshi, vula, firma.

⁸⁹ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1954, D. 980, fl. 1. Proces-verbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, 5 nëntor 1954, me materialin përkatës, mbi marrëveshjen kulturele dhe tekniko-shkencore midis RP. të Shqipërisë dhe RP. të Kinës.

⁹⁰ *Po aty*, fl. 6. Të dyja marrëveshjet janë ratifikuar në Pekin nga komiteti i përhershëm kinez i përfaqësuesve të popullit, më 16 tetor 1954.

⁹¹ *Po aty*, fl. 11. Nga takimi i Behar Shtyllës me Mao Ce Dunin në Pekin, pa datë.

Maos së Shqipëria kishte nevojë për Kinën dhe se kishte nevojë për një kredi me afat të gjatë për pesëvjeçarin e dytë.⁹²

Më 30 nëntor 1954, në protokollin e mbajtur gjatë mbledhjes së Byrosë Politike, pati diskutime të rëndësishme lidhur me zëvendësimin e armatimit aktual të ushtrisë shqiptare.⁹³ Shteti komunist shqiptar varej plotësisht jo vetëm ekonomikisht, por edhe ushtarakisht nga Bashkimi Sovjetik. Ministri i Mbrojtjes Popullore, Beqir Balluku, u ngarkua të kryente negociatat përkatëse për t'i parashtruar kërkesat e RPSH-së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimi Sovjetik.⁹⁴ Është shumë i dukshëm fakti se me gjithë lëvizjet e para drejt Republikës Popullore të Kinës, përsëri Enver Hoxha dhe enturazhi i tij ishin tepër të kujdesshëm në marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik.

Ndërkaq, nga Moska, kishin ardhur në drejtim të qeverisë shqiptare sinjale që të përmirësonte marrëdhëniet me Jugosllavinë ashtu siç kishte vepruar edhe lidhshipi sovjetik.⁹⁵ Nikita Hrushovi kishte nisur procesin e ripajtimit me Jugosllavinë, dhe nëse lideri i komunizmit botëror kishte vendosur kështu, atëherë edhe Enver Hoxha do ta ndryshonte me domosdo kursin e tij në drejtim të Jugosllavisë. Ishte hera e dytë brenda vitit 1954 që lideri komunist shqiptar detyrohej nga Bashkimi Sovjetik të ndërmerre hapa në kundërshtim me vullnetin e tij. Megjithatë, ende nuk kishte ardhur koha të kundërshtonte hapur "bamiësin" nga Moska.

Me Kinën duhej patjetër të mbante marrëdhënie të përzemërta. Kishte ardhur koha që ekonomia shqiptare t'i hapte derën marrëveshjeve me Kinën dhe të përfitonte prej saj kredi. Përpara së të hidhte hapin për të

⁹² *Po aty*.

⁹³ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1954, D. 45, fl. 1. Protokoll i mbledhjes së Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, 30 nëntor 1954.

⁹⁴ *Po aty*.

⁹⁵ *Po aty*, fl. 2. Pjesë nga protokollin e mbledhjes së Byrosë Politike në lidhje me marrëdhëniet me Jugosllavinë: "Në bazë të kërkesës që i është bërë nga ana jonë K.Q. të P.K. të BRSS, në lidhje me vënien në dijeni të anëtarëve të plenumit të KQ, të anëtarëve të qeverisë dhe sekretarëve të parë të komiteteve të partisë në qarqe për letrat e shkëmbyera në mes të K.Q. të Partisë Komuniste të BRSS dhe KQ të Bashkimit të Komunistëve Jugosllavë, Komiteti Qendror i PK. të BRSS i gjeti plotësisht të drejta kërkesat tona dhe është dakord që çështja për të cilën flitet në letrat në fjalë, jo vetëm t'u bëhet e ditur kuadrove udhëheqës të partisë dhe të shtetit, por ato të punohen në një shkallë akomë më të gjerë në parti. Komiteti Qendror i partisë sonë, të marrë një vendim ku të përcaktohet qëndrimi i partisë sonë për përmirësimin e marrëdhënive me Jugosllavinë dhe njëkohësisht të merren masa që vigjilenca e partisë dhe e organeve shtetërore mos të ulët".

firmosur kredinë e parë me kinezët, po në atë mbledhje, Enver Hoxha dikton vullnetin e tij ndaj qeverisë shqiptare që t'i dërgohej një letër falënderimi Komitetit Qendror të Partisë Komuniste dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për dhuratat e konsiderueshme që i kishin sjellë popullit shqiptar me rastin e festës së dhjetëvjetorit të çlirimit.⁹⁶

Kredia e parë kineze për Shqipërinë dhe fillimi i miqësisë shqiptaro-kineze

Delegacioni i lartë nga RPK në Tiranë i kryesuar nga zëvendës-kryeministri dhe ministri i Financave Li Hsien Nien, mbërriti në Tiranë në fillim të dhjetorit 1954. Më 3 dhjetor 1954, me një ceremoni solemne u shpall komunikata e përbashkët kino-shqiptare mbi përfundimin e marrëveshjes së dhënies së një kredie me afat të gjatë RPSH nga RPK.⁹⁷ Sa ishte vlera monetare e kredisë, ky dokument nuk na e sqaron. Në deklaratë thuhej se synimi i kësaj marrëveshjeje ishte të forcohej miqësia vëllazërore ndërmjet popullit shqiptar dhe atij kinez, kur në fakt Shqipërisë i interesonte më shumë të kishte ndihma dhe kredi për të mbajtur në këmbë ekonominë e dobët. Në bisedimet për kredi nga RPK nuk mori pjesë Enver Hoxha, por Mehmet Shehu në cilësinë e kryetarit të qeverisë.⁹⁸

Si rezultat i këtyre bisedimeve u firmos marrëveshja më 3 dhjetor 1954 nga Mehmet Shehu në cilësinë e kryeministrit dhe nga Tuk Jakova në cilësinë e zëvendëskryeministrit për palën shqiptare dhe Li Hsien Nien zëvendëskryeministër dhe ministër i Financave dhe Sju I Sinj në cilësinë e ambasadorit të RPK-së në Shqipëri për palën kineze.⁹⁹ Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes, Enver Hoxha tashmë në cilësinë e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, thjesht asistonte.¹⁰⁰ Në fjalën e tij, Mehmet Shehu e cilësoi marrëveshjen si një provë të gjallë të forcimit

⁹⁶ *Po aty*. Diktuar nga Enver Hoxha, Sekretar i parë i K.Q. të PPSH, më 30 nëntor 1954.

⁹⁷ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1954, D. 889, fl. 1. Marrëveshje mbi dhënien e kredisë me afat të gjatë qeverisë R.P. të Shqipërisë nga qeveria e R.P. të Kinës dhe marrëveshje për shkëmbimin e mallrave dhe pagesave midis R.P. të Kinës dhe R.P. të Shqipërisë.

⁹⁸ *Po aty*. Delegacioni shqiptar në këto bisedime përbëhej nga Mehmet Shehu, kryeministër, Tuk Jakova zëvendëskryeministër, Spiro Koleka president i Komisionit të Planit të Shtetit, Abdyl Këllezi ministër i Financave, Vasil Nathanaili zëvendësministër i Punëve të Jashtme, Zihni Muço zëvendësministër i Tregtisë.

⁹⁹ *Po aty*, fl. 2.

¹⁰⁰ *Po aty*.

dhe zhvillimit të miqësisë shqiptaro-kineze.¹⁰¹ Edhe pse Kina dhe Shqipëria ndodheshin shumë larg gjeografikisht, nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve kishte bërë të mundur që këto dy vende të afroheshin dhe të njiheshin më shumë.¹⁰² Në fjalën e tij, Mehmet Shehu nuk lë pa përmendur BS-në duke thënë se miqësia shqiptaro-kineze ishte e lidhur ngushtë me ekzistencën e Bashkimit Sovjetik.¹⁰³ Shteti lider i komunizmit botëror duhet të vijonte të ishte primar në marrëdhëniet me Shqipërinë edhe për faktin se ishte prezent ushtarakisht thuajse në çdo vend të Evropës Lindore që i përkiste kampit të udhëhequr prej tij. Kryeministri shqiptar nuk lë pa përmendur në fjalën e tij se BS i kishte dhënë dhe jepte ndihmë të madhe dhe të painteres Shqipërisë.¹⁰⁴ Në bazë të kësaj ndihme, Shqipëria ia kishte dalë mbanë sipas Shehut të ndërtonte industrinë e saj të lehtë dhe të zhvillohej në masë të konsiderueshme e gjithë ekonomia e vendit.¹⁰⁵ Në fjalën e tij, kryeministri shqiptar nuk lë pa përmendur edhe ndihmat që merrte Shqipëria për ndërtimin e socializmit nga republikat motra të demokracive popullore.¹⁰⁶ Ndihma e re që Shqipëria po merrte nga Kina, ishte sipas Shehut një ndihmë e sigurtë dhe shprehje e internacionalizmit proletar për forcimin e mëtejshëm të ekonomisë popullore të Shqipërisë.¹⁰⁷ Mehmet Shehu u shpreh i lumtur që iu dha rasti në emër të popullit shqiptar, Qeverisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë t'i shfaqte mirënjohjen e thellë të popullit shqiptar ndaj partisë komuniste dhe qeverisë së RPK-së për këtë ndihmë të madhe dhe bujare.¹⁰⁸

Në vitin 1954, Shqipërisë iu shtua edhe një kredi e re nga ana e Republikës Popullore të Kinës. Të gjitha këto binin në kurriz të popullit

¹⁰¹ *Po aty*, fl. 3.

¹⁰² *Po aty*.

¹⁰³ *Po aty*. "Bashkimi Sovjetik, përbën faktorin vendimtar të jashtëm për çlirimin e vendit tonë, për vendosjen e regjimit të demokracisë popullore dhe për ndërtimin e bazave të socializmit tek ne, ashtu si në gjithë vendet e tjera të demokracisë popullore".

¹⁰⁴ *Po aty*.

¹⁰⁵ *Po aty*.

¹⁰⁶ *Po aty*, fl. 4. Pjesë nga fjala e Mehmet Shehut: "...Republika Çekoslloake, Republika Popullore e Polonisë, Republika Popullore e Hungarisë, Republika Demokratike Gjermane, Republika Popullore e Rumanisë dhe Republika Popullore e Hungarisë. Këto ndihma kanë qenë një faktor me rëndësi për zhvillimin ekonomik të vendit tonë".

¹⁰⁷ *Po aty*.

¹⁰⁸ *Po aty*, fl. 6.

shqiptar dhe brezave të tërë të shqiptarëve që do të duhej të mbanin mbi shpatulla aventurat ekonomike të pushtetit komunist shqiptar. Në fund të fjalës së tij, Mehmet Shehu ishte shprehur se populli shqiptar do ta ruante këtë miqësi përjetë dhe do ta forconte gjithnjë e më shumë.¹⁰⁹ Kjo fjalë e kryeministrit shqiptar do të rezultojë e vërtetë pasi nga ky vit e deri në vitin 1975 nga Kina do të vërshojnë kredi të mëdha për të mbajtur në këmbë ekonominë e Shqipërisë. Kudo do të flitej pas prishjes me Bashkimin Sovjetik në vitin 1961 dhe pas daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës më 1968, vetëm për miqësinë e pathyeshme shqiptaro-kineze.

Nga ana e tij, zëvendëskryeministri i parë i RPK-së Li Hsien Nien, në fjalën që mbajti për këtë rast u shpreh se kjo ngjarje kishte rëndësi të madhe në lidhje me miqësinë dhe bashkëpunimin ndërmjet popullit kinez dhe atij shqiptar.¹¹⁰ Në dallim nga bashkëfirmëtari i tij shqiptar, i cili u shpreh se miqësia shqiptaro-kineze do të ishte e pathyeshme, Li Hsien Nien më me takt u shpreh: "*Le të rrojë ndër shekuj miqësia vëllazërore midis popullit Kinez dhe Shqiptar!*"¹¹¹ Edhe zëvendëskryeministri kinez u tregua u kujdesshëm që për arritjen e kësaj marrëveshjeje të lavdëronte Bashkimin Sovjetik si kryesues i forcave ndërkombëtare të paqes.¹¹²

Po cila ishte përmbajtja e marrëveshjes dhe sa ishte shuma që iu akordua Shqipërisë? Dokumentet dhe materialet që kemi hulumtuar për këtë vit nuk e përmbajnë një informacion të tillë si në rastin e marrëveshjeve kulturore dhe tekniko-shkencore që kemi paraqitur më lart. Në një njoftim të datës 18 dhjetor 1954 me mbishkrimin "Sekret" nga zyra e kryeministrit të Shqipërisë dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, jepet një informacion mbi listën e artikujve që do të propozoheshin të importoheshin përgjatë vitit 1955 nga Republika Popullore e Kinës.¹¹³ Në letrën dërguar nga sekretari i Përgjithshëm i

¹⁰⁹ *Po aty*.

¹¹⁰ *Po aty*, fl. 8. Fjala e zëvendëskryetarit të parë të Këshillit të Ministrave të Shtetit Li Hsien Nien në ceremoninë e nënshkrimit mbi dhënien e kredisë me afat të gjatë qeverisë së R.P. të Shqipërisë

¹¹¹ *Po aty*, fl. 9.

¹¹² *Po aty*.

¹¹³ *Po aty*, fl. 10. Kryeministria, dt. 18.12.1954. Sekret. Dërgohet lista e artikujve që propozohen të importohen gjatë vitit 1955 nga Re. Popullore e Kinës. Ministrisë Punëve të Jashtme, Tiranë. Bashkangjitur ju dërgojmë një listë të artikujve, të nevojshëm për ekonominë e vendit tonë dhe që Qeveria e Republikës Popullore e Shqipërisë mendon të importojë nga Republika Popullore e Kinës në vitin 1955, për

Këshillit të Ministrave, Muhamer Spahiu, nuk jepet asnjë detaj se sa ishte shuma e kredisë që kishte marrë Shqipëria. Lista e artikujve që i është bashkangjitur kësaj letre, na jep ndoshta informacion të saktë sesa mund të ishte shuma e kredisë akorduar nga Kina me marrëveshjen e 3 dhjetorit 1954. Për transparencë ndaj lexuesit listën e mallrave me çmimet përkatëse që do të lëvroheshin nga Kina sipas kredisë, po e paraqesim të plotë:

*Lista e artikujve që propozohen të kërkohen për vitin 1955
nga Republika Popullore e Kinës:*

Nr. R	Emërtimi	Njësia e matjes	Sasia	Vleftha në 000/Rbl	Çmimi për njësi në Rubla
	Kauçuk natyral	Ton	40	220	5.440
	Alumin fletë dhe i punuar	“	100	300	3.000
	Llamarinë e xinguar	“	200	140	700
	Yndyrna industriale	“	300	450	1.500
	Soletë	“	70	370	5.300
	Çelik për prodhim ordiner	“	500	350	700
	Bakër fletë dhe i punuar	“	30	150	4.700
	Bronx lingot	“	50	150	3.000
	Rrjeta peshkimi	“	30	480	16.000
	Letër bobina	“	30	140	4.672
	Pambuk i pastruar	“	500	2.000	4.000
	Kafe natyrale	“	50	330	6.600
	Qumësht pluhur	“	300	330	1.100
	Gjithsej:			-	5.410 ¹¹⁴

Nëse marrim për bazë këtë tabelë, kredia e parë e akorduar Republikës Popullore të Shqipërisë nga Republika Popullore e Kinës ishte 5.410.000 rubla. Por jo, nuk është kjo shuma e saktë e kredisë së

Ilogari të kredisë akorduar vendit tonë me protokoll-marrëveshjen e fundit mbi pagesat dhe shkëmbimin e mallrave, të nënshkruar midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës. Materiali i mësipërm nëpërmjet asaj ministrie, t’i përcillet Ambasadës së Republikës Popullore të Kinës në Tiranë. Sekretari i Përgjithshëm Muhamer Spahiu, firma.

¹¹⁴ *Po aty*, fl. 11.

parë kineze. Pas hulumtimeve më të detajuara në Arkivin Qendror të Shtetit, arrita të gjej shumën e saktë të kredisë së parë nga Republika Popullore e Kinës akorduar Shqipërisë. Shuma e kësaj kredie është 50 milion rubla me 0.5% interes dhe do të shlyhej nga viti 1970 deri në vitin 1980 në masën 54.807.000.¹¹⁵ Kjo kredi do të fillonte të përdorej nga viti 1955 deri në vitin 1960.¹¹⁶ E konvertuar në monedhën kineze ishte e barabartë me 111.000.000 yuan.¹¹⁷

Përfundime dhe një saktësim

Kredia kineze e 3 dhjetorit 1954 akorduar Shqipërisë, hap rrugën për një marrëdhënie të re të Shqipërisë me një vend të fuqishëm komunist. Edhe pse ishte mijëra kilometra larg, lidhja me Kinën e madhe të Mao Ce Dunit do të shpëtonte pushtetin e Enver Hoxhës nëse do të ndodhte prishja e madhe me Bashkimin Sovjetik, që në fakt ishte vetëm shtatë vite larg. Udhëheqja komuniste shqiptare e kishte treguar qartazi se pa ndihma dhe kredi ekonomike nga vendet e Evropës me sistem komunist dhe nga Bashkimi Sovjetik nuk mund të mbijetonte as ekonomikisht dhe, rrjedhimisht as politikisht. Afrimi me Kinën ishte një lëvizje e zgjuar e liderit komunist shqiptar. Hapat e afrimit shqiptaro-kinez në gjysmën e parë të viteve '50 të shekullit të kaluar ishin të ngadalta dhe deri në këtë datë thuajse inekzistente. Zëvendëskryeministri i parë i RPK-së që erdhi në Tiranë për të firmosur marrëveshjen ishte personi, i cili gjatë të gjithë historisë së “dashurisë” së madhe shqiptaro-kineze do të negocionte të gjitha kreditë që Kina do t'i akordonte Shqipërisë nga viti 1954 deri në vitin 1975. Li Hsien Nien është personi që i pari vuri firmën për kredinë e parë nga Kina akorduar Shqipërisë dhe për kredinë e fundit kineze në korrik të vitit 1975.¹¹⁸

¹¹⁵ AQSH, F. 506/BSHSH, V. 1956, D. 20, fleta nuk ka numër; shih në të njëjtën dosje fletën 72.

¹¹⁶ *Po aty*, fl. 72.

¹¹⁷ Frank Dikötter, *Mao's great famine; the history of China's most devastating catastrophe, 1958-1962*, New York: Walker & Co., 2010, f. 74. Kursi i këmbimit rubël/yuan ka qenë 1 rubël=2.22 yuan, dhe rubël/dollar 1 me 1 për vitet '50-'60.

¹¹⁸ Shih artikullin tim "Kredia e fundit kineze për Shqipërinë (1974-1975) – prelude i prishjes së marrëdhënieve mes dy vendeve", në *Studime historike*, nr. 1-2, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018, f. 255; shih edhe Gj. Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë ...*, f. 275.

Brenda dhjetë vjetësh, Kina do të zëvendësonte çdo partner të mundshëm politik dhe ekonomik të Shqipërisë deri në vitin 1978. Kreditë dhe ndihmat kineze ndaj Shqipërisë do të ishin të mëdha. Për korrektësi ndaj kolegëve dhe lexuesit, kërkoj ndjesë për një lapsus në artikullin tim të botuar në revistën “Studime historike”, nr. 3/4, 2018, lidhur me ndihmat dhe kreditë kineze. Saktësoj se kredia e fundit kineze ka qenë 500 milion yuan¹¹⁹ dhe jo 500 milion rubla (1.365.000.000 yuan).¹²⁰ Shifra reale e kredive kineze akorduar Shqipërisë nga dokumentet që kam hulumtuar deri tani është 5.450.626.080 yuan. Nëse kësaj shifre i shtojmë edhe 111.000.000 yuan (50.000.000 rubla) të kredisë së parë që paraqitëm në këtë artikull, deri tani nga hulumtimet e kryera, shifra e kredive kineze akorduar Shqipërisë është 5.561.626.080 yuan e barabartë me 3.476.016.300 dollarë amerikanë.¹²¹ Siç shihet, jemi ende larg të konfirmimit së shifrës prej 10 miliard yuan të pretenduar nga pala kineze në notën dërguar qeverisë shqiptare më 7 korrik të vitit 1978.¹²²

S u m m a r y

ENVER HOXHA'S FORCED RESIGNATION AS PRIME MINISTER OF THE PEOPLE'S REPUBLIC OF ALBANIA AND THE FIRST CHINESE LOAN GRANTED TO ALBANIA, 1954

The December 3, 1954 loan, was the first accredited to Albania from China and paved the way for a new relationship with a powerful communist country. Nonetheless were thousands miles away, the relation with Mao Zedong's China was the 'ace' for Enver Hoxha if would occur the split with the Soviet Union, a fact that was only seven years far away. The Albanian communist leadership had clearly shown that without economic aids and loans from the communist countries of Europe and from the Soviet Union was impossible to survive economically and consequently politically. The approach with China was a smart move of the Albanian communist leader. The steps of

¹¹⁹ *Po aty*.

¹²⁰ Gjon Boriçi "Kreditë dhe ndihmat kineze për Shqipërinë (1956-1975)", në *Studime historike*, nr. 3-4/2018, ASA, Instituti i Historisë, Tiranë: 2019, f. 214-215.

¹²¹ Kursi i këmbimit US\$/Yuan për vitin 1978 ishte 1US\$=1.6 yuan. Shih *po aty*, f. 215.

¹²² *Po aty*, f. 199.

the Albanian-Chinese approach in the first half of the XX century were slow and until this year nonexistent. From now on, these relations would only rise until the year 1978. A new alliance was being forged in the history of Albania during the Cold War.

